

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

### Ndërgjegjja e devotshme<sup>1</sup> / *el-Wera'* / الورع

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ thotë:

“Dhe teshat e tua pastro.” (el-Muddethir, 4)

*Wera'* është ndërgjegjja e përpiktë nga shqetësimi që ndien apo korrektësia që del nga të madhëruarit e Allahut.<sup>2</sup> Kjo paraqet fundin e shkallës së heqjes dorë (*zuhdit*) për shumicën e besimtarëve dhe fillimin e tij (*zuhdit*) për ndjekësin e shtegut të pastrimit shpirtëror.<sup>3</sup> Kjo ka tri nivele<sup>4</sup>:

Niveli i parë është shmangia nga sjellja e shëmtuar:

<sup>1</sup> Po ashtu kjo është përkthyer si devocion i skajshëm, korrektësi, kujdes i përshtirshëm, shmangie që vjen nga devotshmëria, etj.

<sup>2</sup> Disa u shmangen mangësive nga respekti që kanë ndaj vetvetes. Ndërgjegjja e devotshme vjen nga frika ndaj Allahut dhe nga të madhëruarit që i shprehet Atij. Imam Ibn el-Kajjim komentoi këtu duke mos përmendur dashurinë, sepse dashuria ndaj Zotit pa e madhëruar Atë nuk prodhon ndërgjegje të devotshme. Sidoqoftë, mund të thuhet se nivelin më të lartë të ndërgjegjes së devotshme e prodhon kombinimi i dashurisë me madhërim.

<sup>3</sup> Imam Ibn Tejmije tha: “*Wera'* (ndërgjegjja e devotshme) nënkupton shmangien nga ajo që është e dëmshme për ahiretin tënd, ndërsa *zuhdi* (heqja dorë) nënkupton shmangien nga ajo që s’është e dobishme për të.” Kurse *wera'* dhe *zuhdi* përfshihen pjesërisht në njëra-tjetrën, *zuhdi* i ndjekësit të shtegut të pastrimit shpirtëror shkon përtej *wera'*.

<sup>4</sup> Mund të shtojmë se kjo shmangie ndodh në tri nivele: 1) haram; 2) *mekruh* / e urryer apo *shubhah* / e dyshimtë; 3) tejkalime në të lejuarën / *mubah*. Sahabët patën nivelin më të lartë të ndërgjegjes së devotshme, pa teprim dhe shtirje. Për shkak të vështirësisë së zbatimit të nivelit të tyre të *wera'*-s, duhet patjetër të vendosësh prioritete. Kështu, ti duhet t’i shmangesh të dyshimtës (*shubha*), kur ke të bësh me të drejtat e të tjerëve apo dhe kur diçka konsiderohet e pamoralshme a e pahijshme në shoqërinë ku ti jeton. Një kërkuesi të dijës, që i atribuohet një medhhebi (shkolle juridike) të caktuar, i lejohet të kalojë në një medhheb tjetër për të marrë qëndrime më të lehta. Por, në këtë nuk bën ta teprojë duke zgjedhur të gjitha qëndrimet e lehta të të gjitha medhhebeve.

- Për mbrojtjen e vetvetes
- Për shtimin dhe ruajtjen e veprave të mira<sup>5</sup>
- Për ruajtjen e imanit (besimit)<sup>6</sup>

Niveli i dytë është ngelja brenda kufijve të padëmshmes:

- Për ta ruajtur integritetin dhe devotshmërinë
- Për t'u ngritur nga gjërat e ulëta
- Për t'iu shmangur shkeljes së kufijve (të Allahut)

Niveli i tretë është shmangia nga çdo thirrje për t'i ikur:

- Shpërhapjes<sup>7</sup>
- Lidhjes me gjëra që të shpërqendrojnë<sup>8</sup>
- Ndërhyrjeve që të heqin nga afërsia (me Allahun)<sup>9</sup>

*Wera'* është e rëndësishme për çdo besimtar në të gjitha kohët. I Dërguari i Allahut ﷺ tha:

“Lër atë për të cilën ke dyshime, merr atë për të cilën nuk ke dyshime.”<sup>10</sup>

Duke pasur parasysh këtë, duhet shtuar disa detaje të rëndësishme.

– *Wera'* e rreme, është e turpshme

<sup>5</sup> Sepse të qenët i zënë me atë që s'është më e mira, të rrënon apo së paku të shpërqendron nga bërja e veprave të mira.

<sup>6</sup> Sepse sjellja e shëmtuar, pa dyshim, pakëson besimin (imanin) e njeriut, duke qenë se besimi shtohet me dëgjueshmëri dhe pakësohet me mosbindje.

<sup>7</sup> Ta humbësh përqendrimin në kërkimin e hyjnore dhe të kënaqësisë së Tij.

<sup>8</sup> Sepse, pasi të shpërqendrohesh, do të lidhesh me një mori ndjekjesh e dëshirash.

<sup>9</sup> Shpërbërjen e vetvetes (*fanaa*) në këtë shoqërim Imam el-Harawi e konsideron si objektivin përfundimtar. Imam Ibn el-Kajjim komentoi këtu duke thënë se të qëndrosh (*bekaa*) në pajtim me vullnetin e Tij dhe në kërkim të kënaqësisë së Tij është një nivel më i lartë, sepse vetasgjësimi apo shpërbërja (*fanaa*) në Të nënkupton dëshirën e robit, kurse të qëndruarit (*bekaa*) për Të nëpërmjet Tij nënkupton dëshirën e Zotit.

<sup>10</sup> Shënuar nga et-Tirmidhi në autoritetin e el-Hasan ibn Ali.

Nuk mund të thuhet për dikë se ka *wera'* në të lejuarën (hallall), nëse shfrenohet në haram apo gjëra të dyshimta. Disa studentë të Imam Ahmedit përdornin bojën e shkrimit të njëri-tjetrit, kurse Imam Ahmedi i shmangej kësaj nga *wera'* që kishte. Megjithatë, kur disa nga studentët i kërkuan leje për ta shfrytëzuar bojën e tij të shkrimit, ai ua ktheu: “Kjo është *wera'* e errët (e gabuar)”.

- Relativiteti (i *wera'*) është real dhe predikuesit e kohës sonë duhet ta kenë parasysh këtë

Ebu Hurejre ؓ përcolli se pejgamberi ﷺ tha:

“Ju po jetoni në një kohë kur, ai që lë një të dhjetën e asaj për të cilën është urdhëruar, shkatërrohet. Do të vijë një kohë kur, ai që kryen një të dhjetën e asaj për të cilën është urdhëruar, do të shpëtojë.”

Shënuar nga et-Tirmidhi me një zinxhirë transmetimi të diskutueshëm. Megjithatë, ky hadith është saktësuar nga disa dijetarë të Hadithit dhe kuptimi i tij është në përputhje me parimin juridik “Kur ngushtohet (shtrëngohet) çështja, zgjerohet fusha e veprimit / إذا ضاق الأمر اتسع,” i cili hyn në parimin tjetër të përgjithshëm: “Vështirësia autorizon bërjen e lëshimeve / المشقة تجلب التيسير.”

- Përzgjedhja e lehtësimeve dhe ndërgjegjja e devotshme

Për një kërkues të dijes, që i atribuohet një medhhebi, kalimi në një medhheb tjetër për të marrë qëndrime më të lehta është e lejuar, por në këtë nuk bën ta teprojë duke zgjedhur të gjitha qëndrimet e lehta të të gjitha medhhebeve. Për një besimtar të rëndomtë, që nuk ndjek aktivisht një medhheb, e njëjta gjë vlen për sa i përket të pyeturit e dijetarëve të ndryshëm. Për nivelin më të lartë të *wera'* personi duhet t'u shmanget të gjitha gjërave që janë të ndaluara apo të urryera në cilindo medhheb, përveç nëse është i sigurt për vlefshmërinë e qëndrimit apo opinionit më të lehtë.

- Plani i veprimit për realizimin e ndërgjegjes së devotshme (*wera'*)

- Lër atë që është haram.
- Lër të dyshimtën, kur ke të bësh me të drejtat e njerëzve.
- Lër të urryerën që cenon integritetin dhe dinjitetin tënd shpirtëror.
- Lër atë që konsiderohet e pahijshme në shoqërinë ku ti jeton.  
Domethënë, këtu ke të bësh me norma tradicionale. Pastaj, ndërsa

imani yt shkon duke u rritur, vazhdo në përputhje me rrethanat duke shqyrtuar vazhdimisht *wera*'-n tënde për ta verifikuar vërtetësinë e saj.